



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:076586

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06833859

C.nr.345/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Avdirrahman Gashi, me bashkëpunëtorin profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen kontestimore të paditësit B. P. nga L., të cilin e përfaqëson Valon Sadiku av. në Lipjan, me autorizimit, kundër të paditues Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., të cilin e përfaqëson Adem Qehaja nga Prishtinë, me autorizim, për shkak të kompenzimit të dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.21.01.2025, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe autorizuarit të të paditurit, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e precizuar e paditësit B. P. nga L. dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensoj dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar me rastin e shkakimit të aksidentit të komunikacionit të dt.22.02.2022, në lagjen Qendresa ne Qagllavicë dhe atë:

Në emër të dëmit jomaterial

- Për dhimbje fizike në shumë prej 3000.00-€,
- Për frikë të përjetuar shumë prej 2,500.00-€,
- Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 3% shumë prej 3,000.00-€,

Në emër të dëmit material

- Për shpenzime të mjekimit shumë prej 199.80-€,
- Për shkak të ushqimit të përforcuar shumë prej 210.00-€,
- Për shkak të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 210.00-€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e nxjerrjes së aktgjykimit dt.21.01.2025, e deri te pagesa definitive si dhe në të njëjtën kohë t’ia kompenzoj shpenzimet e procedues kontestimore në shumë prej 1,123.60-€, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së precizuar e paditësit dhe atë mbi shumë e gjykuar në emër të dëmit jomaterial për dhimbje fizike në shumë prej 5,000.00-€, për frikë të përjetuar shumë prej 5,000.00-€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumë prej 2,000.00-€, në emër të dëmit material për rehabilitim klimaterik në shumë prej 260-€.

A r s y e t i m

Paditësi B. P. nga L., përmes të autorizuarit të tij Valon Sadiku av. në Lipjan, te kjo gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurit Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në P., për kompenzim të dëmi që i është shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me dt.22.02.2022.

Në padi ka theksuar se me datën 22.02.2022, rreth orës 08:30, në lagjen "Q." në fsh. Ç., ka ndodhur një aksident i komunikacionit rrugor me ç'rast është shkaktuar dëm jomaterial dhe material. Pjesëmarrës në këtë aksident ka qenë Automjeti i markës "...", tipit "...", viti i prodhimit 2008, me numër të targave ..., ngjyrë e kuqe, Automjeti i markës "...", tipit "...", viti i prodhimit 2006, me numër të targave ..., ngjyrë portokalli dhe paditësi në cilësi të këmbësorit. Deri te aksidenti sipas raportit të policisë dyshohet se ka ardhur kur automjeti ".." duke lëvizë mbrapa në mënyrë të pasigurt me pjesën e pasme të rimorkios, ana të djathtë e godet derën e pasme të automjetit "..", i cili në atë moment i kishte dyert e bagazhit të hapura pasi që ka qenë duke u ngarkuar me material ndërtimor në lagjen "..2" (vendpunishte). Pas kësaj goditje që i është bërë automjetit "..", pastaj dera e këtij automjeti e godet në kokë paditësin i cili ka qenë duke ngarkuar material ndërtimor dhe e përplasë për toke ku për pasoj paditësit i humb vetëdija. Në këtë aksident paditësi ka pësuar lëndime fizike të natyrës së rëndë, frikë dhe forma të tjera të dëmit, me ç'rast menjëherë pas aksidentit është dërguar në QE të QKUK-së në Prishtinë ku aty fillimisht i jepet ndihma e parë mjekësore dhe më pas për shkak të lëndimeve të pësuar dhe gjendjes së tij jo të mirë shëndetësore transferohet për në Klinikën e Neurokirurgjisë në QKUK-Prishtinë dhe aty qëndron i shtrirë nga dt.22.02.2022 deri me dt.24.02.2022, ku i është caktuar diagnoza, terapia dhe më pas është liruar për në shtëpi me rekomandim që të i vazhdoj kontrollat mjekësore në mënyrë ambullatore. E paditura detyrimin për shpërblimin e dëmit paditësit e ka mbi bazën e përgjegjësisë për mjetet motorike dhe atë përgjegjësisë në bazë të fajit nga neni 159 par.1 të LMD-së për arsye se automjeti "... me fajin e shoferit të cilit është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguarur te e paditura në kohën e aksidentit dhe atë në bazë të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari e paditësit ka theksuar se mbetet në tërësi si në padi dhe pranë të gjitha deklarimeve. E paditura siç ka deklaruar në seancën përgatitore nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë. Natyra dhe pasojat e lëndimit janë përcaktuar me ekspertizë mjekësore ku është konstatuar ndër të tjera se paditësi në këtë aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore të përcjellura me tronditje në tru. Në atë kohë paditësi ka qenë i moshës relativisht të re rreth 35 vjeçar. Gjykatës i ka propozuar që duke i pas parasysh të gjitha këto rrethana kërkesëpadinë e precizuar të paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar pasi që vetëm në këtë mënyrë do të arrihet qëllimi i shpërblimit të dëmit dhe satisfaksioni i dëshiruar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TA-së, dhe i ka specifikuar.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve nga seancat paraprake, bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë shkallën e lëndimeve të dhëna nga ekspertet të cilët kanë kostatuar se i njëjti nga aksidenti i pësuar me dt.22.02.2022 ka pësuar lëndime të rënda trupore si dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor prej 3%, në bazë të këtyre lëndimeve oferta e dhënë prej 3000 euro është në harmoni me shkallën e lëndimeve, andaj i ka propozuar gjykatës që përtej kësaj oferte pjesën tjetër të kërkesëpadisë ta refuzon si të pabazuar, poashtu ka konfirmuar se e ka pranuar precizimin e kërkesëpadisë për të gjitha format e dëmit material dhe jomaterial e të njëjtin e ka kontestuar për nga lartësia e dëmit sepse një kërkesë e tillë është tejet e lartë dhe nuk është në proporcion me shkallën e lëndimeve të përcaktuar nga ana e ekspertizës. Sa i përket kamatës gjykatës i ka propozuar që të rrjedh prej marrjes së aktgjykimit e mbështetur në dispozitat ligjore dhe në mendimin juridik të Gjykatës Supreme.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas suksesit të procedurës.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe gjykuar drejtë në këtë çështje juridiko-civile, gjykata ka bërë administrimin e provave të propozuara nga palët ndërgjyqësore dhe atë me shiqimin dhe leximin të raportit të policisë me të dt.22.02.2022, së bashku me raportin e aksidentit, me shiqimin dhe leximin e kërkesës për kompensimin e dëmit drejtuar të paditurës e dt.15.03.2022, me shiqimin dhe leximin e raportit të QKUK-së së bashku me raportet tjera mjekësore, me shiqimin dhe leximin e ekspertizës mjekësore të ekspertëve Dr. Avdullah Fazliu, Ortopoed-Traumatolog, Dr. Agon Mekaj-Neurokirurg dhe Dr.Muhamet Karameta-Psikiater te dt.14.11.2024, e të cilat prova gjykata i administroi dhe i vlerësoi në vështrim të dispozitave nga

neni 8 i LPK-së, ku gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe pjesërisht e pabazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga raporti i aksidentit me nr.2022-AR-0500 të dt.22.08.2022, së bashku me raportin e policisë e aksidentit, vërtetohet paditësi me dt.22.08.2022 rreth orës 08:30 min në lagjen "... " në fsh. Ç..., ku është shkaktuar aksidenti i komunikacionit rrugorë në mes dy automjeteve njëri i ndaluar dhe një këmbësor, ku si pasoj e këtij aksidenti këmbësori ka pësuar dëm material dhe jomaterial.

Nga raportet e QKUK-së të dt.22.02.2022 së bashku me raportet tjera, vërtetohet se paditësi B. P. rreth orës 09:00 ka pranuar trajtim mjekësor në QKUK-Prishtinë, pasi që i njëjti ka pësuar lëndime trupore në këtë aksident dhe nga raportet tjera mjekësore që gjinden në shkresat e lëndës, vërtetohet se paditësit ditët në vazhdim pas aksidentit ka pasur trajtime mjekësore.

Nga kërkesa për kompensimin e dëmit drejtuar të paditurës e dt.15.03.2022, vërtetohet se paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Valon Sadiku ka parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit në aksidentit e shkaktuar me dt.22.02.2022 në KS "S." me seli në P. me qëllim që të arrihet një marrëveshje jashtëgjyqësore.

Nga ekspertiza mjekësore të ekspertëve Dr. Avdullah Fazliu, Ortoped-Traumatolog, Dr. Agon Mekaj-Neurokirurg dhe Dr. Muhamet Karametaj-Psikiatër e dt.14.11.2024, vërtetohet se paditësi në këtë aksident komunikacioni ka pësuar lëndime trupore dheate si Dg.Commotio [cerebri.St.post](#) vulnus regio occipitalis -S.post contusion art.H/S lat.dex et regio L/S të cilat lëndime konsiderohen lëndime të rënda trupore. Paditësi si pasojë e këtyre lëndimeve ka përjetuar Dhëmbje fizike të intensitetit posaqerisht të lartë - ka patur përfaqësisht gjysëm ore duke marrë parasysh vendin e ndodhjes së aksidentit e deri te dhënja e ndihmës së parë në QE në QKUK-Prishtinë ku i janë bërë egzaminimet e nevojshme, qepja e plagës etj., dhëmbje me intensitet të lartë-ka patur për 72 orë, ndërsa dhëmbje të intensitetit të mesëm për 21 ditë për shkak të dhëmbjeve që ka pas si pasojë e lëndimeve në kokë art.H/S të djathtë dhe regjionin lumbosacral, dhëmbje të intensitetit të ulët janë të pranishme edhe sot kohë pas kohe e sidomos me ndryshimin e kushteve klimatike. Ndërsa paditësi ka pasur Frikë primare në momentin e aksidentit, ka qenë e përjetuar në formë të frikës nga vdekja (në momentin e goditjes së derës së veturës me kokë si pasojë e goditjes nga një makinë tjetër), që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë është manifestuar me simptome të ankthit të gjeneralizuar, frikë, frikë nga procedurat mjekësore, harresë e theksuar, marramendje, çrregullim të gjumit, rikujtime dhe ripërjetime të shpeshta të ngjarjës traumatike, labilitet emocional, çrregullim të disponimit e që nënkupton reagimin akut në stres, që ka zgjatur 10 ditë, frikë sekondare e intensitetit mesatar që ka zgjatur rreth 5 muaj dhe që kanë vazhduar e është manifestuar me reagime emocionale të karakterit anksioz, çrregullim të gjumit, zgjime të herë pas herëshme gjatë natës me rikujtime dhe ripërjetime të ngjarjës traumatike. Vështirësi, lodhje e shpejtë në angazhimet minimale në amvisri, rënje e aktivitetit, rënje të vëmendjes e të koncentrimit dhe rënje të vullnetit e të disponimit. Për çka ka kërkuar edhe ndihmën e psikiatrit. Frikë sekondare e intensitetit të ulët që ka zgjatur afer 10 muaj, e që kanë vazhduar e është manifestuar me simptomet e njëjta si në pikën c, por me intensitet më të ulët. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Zvogëlim të aktivitetit të përhershëm jetësor ka për 3% sipas Rregullores për dëmshpërblimet e dëmeve jo materiale të hartuan nga BOK dhe MSH dt.03.20.2016 nr.118/16, Kreu I, Pika 1 nën pika 1.2.1 (në rastet e konstatimit spitalor të tronditjes trunore brenda 24 oreve pas aksidentit). Përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme për 21 ditë, mundësisë së kryerjes së higjienës personale pas plagës prerëse në kokë. Ushqimi ka qenë i nevojshëm për 15 ditë, ushqim i pasur me proteina, vitamina dhe minerale. Terapia dhe rehabilitimi ka qenë i nevojshëm për 10 ditë për vitin e parë në ndonjë Qender Rehabilituese.

Mbi bazën e këtyre provave të administruara më lartë e të cilave prova gjykata në tërësi iu fali besimin, pasi që deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar e kundërta nga ajo siç është vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, vërtetohet se paditësi B. P. në këtë aksident të komunikacionit ka pësuar lëndime trupore të cilat

janë përshkruar më lartë nga ekspertët mjekësor për qka me dt.22.08.2022 ka kërkuar trajtim mjekësor në QKUK në Prishtinë si rezultat i lëndimeve që ka pësuar, e që deri tek aksidenti ka ardhur me fajin ekskluziv të drejtuesit të automjetit "A" "...", tipit "...", me numër të targave ..., të cilin e ka drejtuar E. B. i cili ishte duke lëvizur në Lagjen .. duke lëvizur mbrapa në mënyrë të pa sigurt me pjesën e pasme të rimorkios ama e djathtë e godet derën e pasme të automjetit "B" VW Kombi i cili i ka pasur dyert e hapura të bagazhit i cili ka qenë duke ngarkuar materialin ndërtimor ku dera e kombit pastaj e godet në kokë njërin prej punëtorëve këtu paditësin duke u përplasur në tokë pa vetëdije, ku i njëjti si rezultat i kësaj pëson lëndime trupore dhe automjeti me fajin e të cilit është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar tek e paditura, andaj kjo e fundit konform nenit 159 të LMD-së duhet të përgjigjet për dëmin që ka pësuar paditësi në këtë aksident të komunikacionit.

Gjithashtu gjykata duke pasur parasysh kërkesëpadinë e paditësit për kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial që ka pësuar në aksidentin e komunikacionit dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 323 të LPK-së, dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës të dt.27.02.2023 për caktimin e kriterëve për shpërblimin në të holla të dëmit jomaterial, në emër të dhimbjeve fizike duke marrur parasysh intenzitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve siç kanë vlerësuar ekspertët përkatës, gjykata ia gjykoi shumën prej 3,000.00-€. Ndërsa në emër të frikës së përjetuar duke marrur parasysh kohëzgjatjen dhe intenzitetin e frikës që ka përjetuar paditësi në këtë rast siç ka vlerësuar eksperti përkatës ia gjykoi shumën prej 2,500.00.-€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkall prej 3% ia gjykoj shumën prej 3,000.00-€ këtë duke e marrë parasysh mendimin e eksperteve si dhe moshën e re të paditësit. Në emër të dëmit material, për ndihmen dhe kujdesin e personit të tretë siç kanë vlerësuar ekspertët përkatës që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë në kohëzgjatje prej 21 dite ia gjykoi shumën prej 120.00-€, aq sa ka kërkuar paditësi, në emër të ushqimit të përforcuar ia gjykoi shumën prej 105.00-€, për çdo ditë nga 7-€, ashtu që paditësi ka pasur nevojë për 15 dite ushqim të përforcuar ia gjykoi shumën e lartëpërmendur si dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit ia gjykoi shumën prej 199.80-€ të dokumentuara me fatura që gjinden në shkresat e lëndës.

Me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit sidomos të dëmit jomaterial gjykata u bazua në nenin 183 të LMD-së, me të cilin nenin parashifet se për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore përshkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetesës, shëmtimit si dhe frikës, gjykata konstatoi rrethanat e rastit sidomos intenzitetin e dhimbjeve dhe frikës dhe zgjatjen e tyre e arsyetojnë këtë do të gjykon shpërblimin e drejtë në të holla, duke marrë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim, por të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqëror, ndërsa format e dëmit material gjykata i gjykoi konform nenit 173 dhe nenit 179 të LMD-së, me të cilat dispozita parashifet që personi përgjegjës të dëmit material ka për detyrë ta rivendos gjendjen e mëparshme para se të shkaktohej dëmi si dhe në rastin e shkaktimit të lëndimeve trupore i dëmtuari ka të drejtë që t'i kompenzohen shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë.

Gjykata duke pasur parasysh se lartësia e kërkesëpadisë së paditësit nuk ka qenë në tërësi e bazuar dhe e argumentuar andaj ka vendosur si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kompenzimin në emër të dëmit jomaterial përshkak dhimbjeve fizike në shumën prej 5,000.00-€, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 5,000.00-€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumë prej 2,000.00-€ si dhe dhe në emër të rehabilitimit klimaterik shumën prej 260-€ (pasi që me asnjë provë pala paditësi nuk e ka argumentuar se ka shpenzuar për rehabilitim) pasi që shumat e gjykuara nga ana e gjykatës janë në proporcion me dëmin e shkaktuar të paditësit, standartin shoqëror me të cilën jeton paditësi, praktikën gjyqësore dhe këto shuma paraqesin një lloj satisfaksioni moral për paditësin për lëndimet që i ka pësuar, ndërsa shumat mbi pjesën e aprovuar nuk paraqesin respektivisht nuk janë në pajtim me natyrën e lëndimeve të paditësit dhe qëllimit shoqëror që i shërben kompensimi në fjalë, andaj pjesën e

kërkesëpadi së precizuar mbi shumat e gjuara gjykata e refuzoi si të pa bazuar më konkretisht si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur, mirëpo të njëjtat pretendime pjesërisht i ka refuzuar si të pa bazuara pasi që baza juridike e padisë nuk ka qenë kontestuese por vetëm lartësia e kërkesëpadi së dhe nga provat e përmendura më lartë, praktikës gjyqësore që bazohet në udhëzimin e Gjykatës Supreme për kompensimin e dëmit jomaterial për lëndimet e pësuar ia gjuoj kompensimin e arsyshëm për paditësin që ka pësuar në këtë aksident të komunikacionit, ndërsa mbi shumat e gjuara gjykata i aprovoj pretendimet e të paditurës për qka edhe i refuzoj shumat duke vendosur si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Në këtë procedurë pala paditëse e ka fituar kontestin në pjesen më të madhe dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata në mbështetje të dispozitave të nenit 452 dhe 453 të LPK-së, e detyroi të paditurën që palës paditëse t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00-€, për precizimin e kërkesëpadi së në shumë prej 104.00-€, për përfaqësimin e 3 seancave gjyqësore (135.20-€ x 3) në shumë prej 405.60-€, për taks gjyqësore në shumë prej 60.00-€, për ekspertiza mjekësore në shumë prej 450.00-€, apo shumën e përgjithshme në shumë prej 1,123.60-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti, për çka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe dispozitave të lartecekura si dhe neni 136 të LMD-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN
C.nr.345/22 me dt.21.01.2025

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2022:076586
Datë: 11.02.2025
Numri i dokumentit: 06833859